

**Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare - Konferencë Kombëtare**  
**“SFIDAT E ZHVILLIMIT TË TREGJEVE NËN MBIKËQYRJEN**  
**E AMF-SË DHE EDUKIMI FINANCIAR”**  
**24 Maj 2018 - Tiranë, Shqipëri**

**SHPËRBLIMI I SIGURIMIT NË RASTET E SIGURIMIT TË PRONËS**

*Enea Sheqi<sup>1</sup>*

**Abstrakt**

Pronësia është një nga të drejtat themelore të njeriut dhe ushtrimi i kësaj të drejte shpeshherë është i gërshetuar me rreziqe. Kostot e shfaqura gjatë ekspozimit ndaj dëmeve të ndryshme, për familjarët dhe bizneset janë një tarifë e lartë, të cilat kanë nevojë të sigurohen. Mbrojtja e pronës ndaj rreziqeve të ndryshme duke paguar primin ndaj një shoqërie siguruese, i jep të drejtën për dëmshpërblim të siguruarit në mënyrë që ai të ushtrojë efektivisht këtë të drejtë dhe të mos pësojë humbje financiare të rënda.

Kuadri ligjor shqiptar është i pasur në këtë fushë, duke na ofruar bazat e tij në Kodin Civil dhe aktet e tjera nënligjore. Gjatë sigurimit të pronës shfaqen disa problematika në lidhje me ngjarjen e sigurimit dhe shkaktimin e dëmit. Në vijim të punimit do të bëhet një analizë e hollësishme e parimeve të shkaktimit të dëmit, vërtetimit të tij, pozitës së të siguruarit në vërtetimin e ngjarjes së sigurimit si dhe kriteret e vlerësimit.

Gjithashtu do të bëhet një pasqyrë e kriterëve të jurisprudencës kombëtare dhe evropiane të masës së shpërblimit të dëmit. Kërkimi doktrinal i kombinuar me analizën e praktikës gjyqësore do të shërbejë për të treguar rastet dhe metodat e shpërblimit në sigurime gjatë sigurimit të rreziqeve të ndryshme që mund t'i kanosen pronës.

***Fjalë kyçe:*** *Sigurimi i pronës, Rrezik, Shkaktimi i dëmit, Shpërblimi në sigurime.*

---

<sup>1</sup> Student në Master Shkencor Civil, Fakulteti i Drejtësisë-Universiteti i Tiranës, Email: [enea.sheqi@yahoo.com](mailto:enea.sheqi@yahoo.com)